

**RREGULLORJA MBI PROCEDURAT PËR PARAQITJEN E NJË KËRKESE, SHQYRTIMIN E SAJ DHE AFATET E NJOFTIMIT KUR KLIENTI DYSHON NË SAKTËSINË E TË DHËNAVE TË APARATIT MATËS TË ENERGIJISË ELEKTRIKE**

**PJESA E PARË DISPOZITA TË**

**PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është që të përcaktohen kushtet dhe procedurat për paraqitjen, shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të klientëve në lidhje me saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike si edhe afatet kohore për trajtimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave.

**Neni 2**

**Baza ligjore**

Kjo rregullore bazohet në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike”, neni 77, pika 6, “Verifikimi i Matësve”.

**Neni 3**

**Objekti**

Objekti i kësaj rregullore do të jenë kërkesat e Klientëve lidhur me saktësinë e matësit të energjisë elektrike të instaluar nga Operatori i Rrjetit tek klienti.

**Neni 4**

**Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore përcakton procedurën e paraqitjes së kërkesës, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuarit për rastet kur ai dyshon në saktësinë e matësit të energjisë elektrike në mënyrë që:

1. Të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë klientëve, në respekt të të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me saktësinë e matjes së energjisë elektrike të konsumuar prej tyre.
2. Të mbrojë Klientët përmes promovimit të qasjes transparente ndaj kërkesave që kanë të bëjnë me saktësinë e matjes së energjisë elektrike të regjistruar nga matësi elektrik të instaluar te klienti.
3. Të sigurojë përmbushjen e kritereve të matjes së energjisë elektrike në mënyrë transparente.
4. Të garantojë zhvillimin e një procedure të shpejtë dhe transparente për trajtimin e kërkesave të

Klientëve nga Operatori i Rrjetit.

5. Të garantojë trajtimin e kërkesave në zbatim të procedurave dhe afateve të zgjidhjes së kërkesave, sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë Rregullore.
6. Çdo ankesë që lidhet me elementet e veprës penale dhe vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në Ligjin Nr. 43/2015 “Mbi Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk trajtohen në këtë rregullore dhe janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente.

## **Neni 5** **Referencat**

Referencat ligjore të përdorura në këtë rregullore janë:

- Ligji Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" ;
- Ligji Nr.9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë” i ndryshuar ;
- Ligji Nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”;
- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012;
- Kodi i Matjes (i miratuar nga ERE) ;
- Kontrata Tip e Shërbimit të verifikimit të matësive të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre (miratuar nga ERE) ;
- Metodologjia e llogaritjes së dëmit ekonomik (të miratuar nga ERE) ;

## **Neni 6** **Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin si në vijim dhe çdo term tjetër i parashikuar në këte rregullore do ketë kuptimin e termave të përcaktuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjin Nr.9875, datë 14.02.2008, “Për Metrologjinë”, i ndryshuar :

**“Enti Rregullator i Energjisë”** ose **“ERE”** është autoriteti rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, i cili funksionon në përputhje me ligjin Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

**“Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë”** ose **“DPM”** është person juridik, publik, i specializuar për metrologjinë dhe që zhvillon aktivitetin në mbështetje të Ligjit Nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

**“Operator i Rrjetit”** është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes.

**“Klient”** është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

**“Klient fundor”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

**“Klient familjar”** është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale.

**“Klientë jofamiljarë”** janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.

**“Kodi i Matjes”** është tërësia e rregullave teknike dhe normat minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e Energjisë Elektrike, me qëllim matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike.

**“Matës energjie”** janë aparate matëse që masin energjinë elektrike nëpërmjet integritit të fuqisë elektrike në lidhje me kohën respektive.

**“Klasa e saktësisë”** - është klasa e matësit të energjisë elektrike që plotëson kërkesat metrologjike të deklaruara, të cilat kanë për qëllim që të mbajnë gabimet e matjes ose pasiguritë e matjes brënda kufijve të përcaktuara nën kushtet e punës specifike.

**“Gabimi i matjes”** - është tregimi i matësit minus vlerën e vërtetë.

**“Gabimi relativ”** është ai që rezulton nga formula e mëposhtme:

Gabimi në përqindje =  $(\text{energji i regjistruar} - \text{vlerën e vërtetë}) \times 100 / \text{vlerën e vërtetë}$ .

**“Gabimi maksimal i lejuar”** ose **“GML”** është vlera më e madhe e gabimit të matjes, në përputhje me një vlerë referencë të njohur, e cila lejohet nga specifikimet ose standardet për një instrument matës apo sistem matjeje.

**“Verifikim”**- është konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit, nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.

**“Autorizim”** është dhënia e së drejtës për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të instrumenteve matëse në sferën e detyrueshme, subjekteve publike dhe private, vëndase ose të huaja, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

**“Subjekti i Autorizuar”** është subjekti i autorizuar nga DPM për të kryer shërbimin e verifikimit dhe të vulosjes së matësit elektrik.

## **PJESA E DYTË**

### **ANKESAT E KLIENTËVE PËR SAKTËSINË E MATËSIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

#### **Neni 7**

#### **Procedurat e paraqitjes së një kërkesë për verifikimin e saktësisë së matësit elektrik dhe shqyrtimin e saj**

1. Nëse klienti dyshon në saktësinë e matësit elektrik në përdorim të tij, ai paraqet një kërkesë, pranë zyrave të Operatorit të Rrjetit si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës, për verifikimin e aparatit matës të energjisë elektrike.
2. Në rastet kur klienti paraqet një kërkesë për verifikim të saktësisë të aparatit matës të energjisë elektrike pranë institucioneve të tjera përgjegjëse, ato do të rregjistrojnë kërkesën e tij dhe do t’ia përcjellin Operatorit të Rrjetit në zbatim të afateve kohore për trajtimin e kërkesave.
3. Në të gjitha rastet, institucioni përgjegjës, të cilit i është drejtuar kërkesa e klientit për verifikim të saktësisë të aparatit matës të energjisë elektrike, do të vërë në dijeni dhe klientin për përcjelljen e kërkesës së tij pranë Operatorit të Rrjetit.
4. Me paraqitjen e kërkesës, përfaqësuesi i Operatorit të Rrjetit është i detyruar të rregjistrojë kërkesën dhe të pajisë klientin me një numër unik të kërkesës së paraqitur.
5. Kërkesa e paraqitur nga klienti, pranë zyrave të Operatorit të Rrjetit si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës, për verifikimin e aparatit matës të energjisë elektrike, do të jetë subjekt i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

6. Operatori i Rrjetit planifikon realizimin e shërbimit të verifikimit të saktësisë të aparatit matës të energjisë elektrike tek klienti jo më vonë së 5 ditë pune prej ditës së paraqitjes së kërkesës.
7. Operatori i Rrjetit njofton klientin me shkrim, brenda 3 ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, për ditën dhe orën kur parashikohet të kryhet verifikimi i saktësisë së matësit elektrik tek klienti.
8. Operatori i Rrjetit planifikon realizimin e shërbimit të verifikimit duke njoftuar DPM-në ose personin juridik të autorizuar prej saj për verifikimin e matësve elektrike, që mbulon zonën administrative të klientit që ka paraqitur kërkesën. Nëse matësi elektrik ka qënë i verifikuar më parë nga subjekti i autorizuar që mbulon zonën administrative të klientit që ka paraqitur kërkesën, Operatori i Rrjetit njofton një subjekt të autorizuar që kryen aktivitetet në një zonë tjetër administrative që të kryejë këtë shërbim.
9. Operatori i Rrjetit dhe subjekti i autorizuar kryejnë shërbimin e verifikimit të matësit elektrik për saktësinë e të cilit është ankuar klienti. Verifikimi i saktësisë do të kryhet në prezencën e Operatorit të Rrjetit, subjektit të autorizuar për verifikimin e matësve elektrike si edhe në prezencë të klientit që ka paraqitur kërkesën.
10. Shërbimi i verifikimit të matësit tek klienti do të kryhet pa e shkëputur matësin elektrik nga lidhjet elektrike. Regjime të ndryshme ngarkese do të realizohen ose nëpërmjet vetë klientit ose duke realizuar ngarkesa të ndryshme në vend nga subjekti i autorizuar.
11. Nëse gjatë verifikimit në terren subjekti i autorizuar nuk është në gjendje të gjykojë mbi saktësinë e matësit të energjisë elektrike, atëherë ai kërkon që aparati matës të testohet në kushte laborator. Kjo kërkesë dëshmohe duke vendosur nga ana e tij etiketa sigurie Ri-Testim në Laborator.
12. Me përfundimin e verifikimit përgatitet raporti i testimit i cili firmoset nga përfaqësuesi i Operatorit të Rrjetit dhe përfaqësuesi i subjektit të autorizuar. Një kopje e raportit të testimit i dorëzohet edhe klientit që ka paraqitur kërkesën.
13. Nëse aparati matës i konstatuar i dëmtuar do t'i nënshtrohet procesit të riparimit, Operatori i Rrjetit njofton më parë Klientin për këtë, duke i bërë me dije këtë të fundit afatet brenda të cilave mund të kërkojë të ushtrojë të drejtën për të kërkuar ritestim të aparatit pranë një tjetër subjekti të autorizuar nga DPM.
14. Nëse gjatë verifikimit të matësit elektrik, nga ana e Operatorit të Rrjetit konstatohen parregullsi apo ndërhyrje të paautorizuara në sistemin e matjes, që ndikojnë në rregjistrimin e konsumit të energjisë elektrike dhe nuk përbëjnë vepër penale, merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve, në të cilat është ndërhyrë, përllogarit dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme, sipas metodologjisë së llogaritjes së dëmit të miratuar nga ERE dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi

## **Neni 8**

### **Interpretimi i rezultateve të verifikimit të Kërkesës mbi saktësinë e matësit elektrik**

1. Kur pas verifikimit nga subjekti i autorizuar në prani të përfaqësuesit të Operatorit të Rrjetit dhe klientit që ka paraqitur kërkesën, konstatohet se gabimi i matjes i rregjistruar pas verifikimit është përtej gabimit maksimal të lejuar (minus ose plus) dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje të bëra nga klienti, atëherë Operatori i Rrjetit kryen përllogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, sipas rezultatit të pasaktësisë në matës dhe në këtë mënyrë bëhet rimbursimi sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në Kodin e Matjes.
2. Rregullimet për pasaktësitë e matjeve do të kufizohen për një periudhë të përcaktuar, në përputhje me parashikimet e bëra në Kodin e Matjes.

3. Nëse testimi për qëllime verifikimi është kryer në kushte laborator, si pikë referuese për vlerësimin e kompensimit do të shërbejë diferenca midis gabimit të matjes që rezulton në matës pas testimit dhe gabimit maksimal të lejuar sipas klasës së saktësisë së vetë matësit elektrik. Gabimi i matjes së matësit llogaritet në pikën referuese të ngarkesës si më poshtë:
  - a. Matësa 1(një) fazorë : Ngarkesa simetrike nominale(bazë),  $I=100%$ , për  $\cos\phi=1$
  - b. Matësa 3(tre) fazorë : Ngarkesa simetrike nominale(bazë),  $I=100%$  (L1,L2,L3) për  $\cos\phi=1$
4. Nëse testimi për qëllime verifikimi është kryer në kushte terreni me instrumenta etalon referues portative, si pikë referuese për vlerësimin e kompensimit do të shërbejë diferenca midis gabimit të matjes që rezulton në matës pas testimit me 1.5 x klasën e matësit elektrik.
5. Matësi që rezulton i rregullt, pas verifikimit do të vulozet në përputhje me parashikimet e kontratës tip “Mbi verifikimin e matësive të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre”, të miratuar nga ERE. Matësi që rezulton jo i rregullt do të identifikohet me anën e një çift etiketash sigurie që tregon se matësi është jo i rregullt. Operatori i Rrjetit do të kryejë zëvendësimin e këtij matësi që rezulton jo i rregullt, duke njoftuar paraprakisht me shkrim klientin, brenda tre ditë pune prej ditës së verifikimit nga subjekti i autorizuar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe Kodit të Rrjetit të Shpërndarjes.

## **Neni 9**

### **Afati i realizimit të shërbimeve**

1. Realizimi i shërbimit të verifikimit të saktësisë së matësit elektrik të klientit, i cili ka bërë kërkesë pranë Operatorit të Rrjetit, kryhet brenda 5 ditëve pune prej ditës së paraqitjes së kërkesës në zyrat e Operatorit të Rrjetit.
2. Brenda 3 ditëve pune prej ditës së kryerjes së shërbimit të verifikimit të matësit elektrik, Operatori i Rrjetit paraqet vlerësimin ndaj kërkesës së bërë dhe ia dorëzon klientit.

## **Neni 10**

### **Ankimimi i kërkesës**

1. Në rastet kur klienti nuk është i kënaqur me trajtimin e kërkesës nga Operatori i Rrjetit apo kur klienti nuk është dakord me vlerësimin e bërë nga Operatori i Rrjetit pas verifikimit të matësit elektrik, atëherë klienti paraqet një ankimim pranë institucioneve përgjegjëse mbi trajtimin e kërkesës që lidhet me verifikimin e saktësisë e matësit elektrik.
2. Ankimimi i kërkesës së paraqitur do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, referuar:
  - Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”;
  - Ligjit Nr. 9875, datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë”, i ndryshuar;
  - Ligjit Nr.9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar;

- Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2012;
- Kodit të Procedurave Administrative.

## **PJESA E TRETË**

### **Neni 11**

#### **Detyrimet financiare**

1. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, atëherë shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur kërkesën, në përputhje me tarifat tavan për verifikimin e matësve, të miratuara me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë përgjegjëse për energjinë.
2. Tarifat tavan për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë përgjegjëse për energjinë, sikurse përcaktohet në Ligjin Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".

## **PJESA E KATËRT**

### **Neni 12**

#### **Dhënia e informacionit**

1. Operatori i Rrjetit do të paraqesë informacion 4-mujor në ERE në lidhje me kërkesat e klientëve për verifikimin e saktësisë së aparatit matëstë energjisë elektrike.
2. Forma e informimit do të jetë sipas formularit paraqitur në Aneksin bashkëlidhur rregullores.

### **Neni 13**

#### **Rishikimi dhe ndryshimi i rregullave**

Kjo rregullore është objekt rishikimi ose ndryshimi me Vendim të Bordit të ERE-s, me kërkesë të Operatorit të Rrjetit ose me iniciativë të vetë ERE-s.

### **Neni 14**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

